




REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS



Në bazë të nenit 68, paragrafi 3, i ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 datë 04.06.2008 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28, datë: 04.06.2008), neni 4, paragrafi 1 dhe neni 6, paragrafi 1, pika 1.3 i Udhëzimit Administrativ MAPL nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit me publik në Komuna i datës 31.12.2018, Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Gjakovë me datën 09.06.2025 shpallë këtë:

NJOFTIM


Për mbajtjen e konsultimit publik me qytetarë, dhe grupet e interesit për Kornizën Afatmesme Buxhetore, KAB 2026 – 2028.

Të nderuar bashkë qytetarë të Komunës së Gjakovës, përfaqësues të shoqërisë civile – OJQ, grupe të interesit dhe të gjithë ju të interesuar, ju njoftojmë se të hënen me datën 16.06.2025 me fillim nga ora 11:00, në sallën e Asamblesë Komunale pranë objektit të Komunës do të mbahet takim i hapur me qytetarët dhe kryetarët e këshillave lokal dhe shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, KAB 2026 – 2028 të Komunës së Gjakovës.

Në takim do të informoheni mbi KAB-in Komunal dhe do të mund të drejtoni pyetje, kërkesa për të cilat do të ju përgjigjen te pranishmit dhe njëkohësisht kërkesat tuaja mund të përfshihen në KAB.

Pjesëmarrja juaj në këtë takim dëshmon aktivizimin qytetarë dhe përfshirjen tuaj në vendimmarrje.

Gjakovë,
09.06.2025


Durim Halilaj
Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

